



Planina / Dorezimi Punimes / Predatori Received / Delivered	02.03.2021	1	viti god year
Organ / Rreza Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKIMSHK	893/2021	Sasia Kolicina Quantity
			1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.25/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.25/2021 të datës 25.01.2021, të parashtruar nga ankuesit dhe kudër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.03.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.25/2021 e datës 25.01.2021, e parashtruar nga ankuesit dhe

**A r s y e t i m**

Ankuesit dhe të punësuar në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave pran Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 25.01.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 281/2021 të regjistruar me numër A.nr.25/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën për kompensim të punës jashtë orarit për periudhën mars, prill dhe maj të vitit 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Ndërsa Këshilli me datë 22.02.2021 ka pranua nga Ministria e Punëve të Brendshme, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 748/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosies e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:281/2021 të datës 25.01.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosjen e punës jashtë orarit të datës 26.05.2020 për muajin mars 2020, Dosjen e punës jashtë orarit të datës 26.05.2020 për muajin prill 2020, Dosjen e punës jashtë orarit të datës 26.05.2020 për muajin maj 2020, Kërkesën e UD. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së

Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të datës 07.05.2020, Listën e nënshkrimeve të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për datat nga 20 mars deri 31 mars të vitit 2020, Listën e nënshkrimeve të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për datat nga 01 prill deri më 30 prill të vitit 2020, Listën e nënshkrimeve të Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për datat nga 01 maj deri më 31 maj të vitit 2020, Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.02.2021 me numër protokolli 423/2021, Përgjigjen në ankesë të datës 22.02.2021 me numër prokolli 748/2021, Vendimin e UD. Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të datës 14.04.2020 me numër 225/2020, Listën e hyrje-daljeve për periudhën kohore nga data 01.03.2020 deri me datë 31.05.2021, Listën e pagave për ankuesit për muajt mars, prill dhe maj 2020, Kontratën e marrëdhënies e punës së ankuesit \_\_\_\_\_ te datës 01.08.2019 me numër 03/2019, Akt Emërimi e ankuesit \_\_\_\_\_ të datës 22.05.2014; Ankesën e ankuesve \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të parashtruar në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 13.01.2021, e-mailin e datës 19.01.2021 të Menaxheres se Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e-mailin e datës 23.02.2021 me provat e bashkangjitura, Kërkesën e ankuesve e parashtruar të U.d Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 05.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ A.nr. 25/2020 e datës 25.01.2021 është e jashtë afatshme, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi \_\_\_\_\_ ka themeluar marrëdhënie punë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhë tri (3) vjecare bazuar në Marrëveshjen për Bursë në mes të Zyrës së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës të datës 12.07.2016, sipas Kontratës Nr. Protokolli 541 të datës 01.08.2019, në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Integrim Evropian, ndërsa ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt Emërimit të datës 20.05.2014, mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave.

Bazuar në Vendimin Nr.121/2020 te datës 22.03.2020 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (me tej MPBAP), si dhe listave të nënshkrimeve, ankuesit për periudhën kohore mars, prill dhe maj 2020 kanë qenë të angazhuar në Qendrën Operative të MPBAP, e themeluar me qëllim të koordinimit të institucioneve në parandalimin e COVID-19 dhe e cila Qendër ka punuar në orar pune 7/24, ndërsa me Vendimin Nr.225/2020 të datës 14.04.2020 të Ministrit të MPBAP, ankuesit janë caktuar si staf esencial i Ministrisë.

Ankuesit me datë 05.06.2020 i janë drejtuar Sekretares së Përgjithshme për kompensim te punës jashtë orarit për periudhën mars, prill dhe maj 2020 dhe pas heshtjes në kërkesën e tyre me datë 13.01.2021 kanë parashtruar ankesë me bazë të njëjtë juridike në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me datë 19.01.2021 Menaxherja e Burimeve Njerëzore e MPB-së, ka udhëzuar ankuesit që të parashtrojnë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Me tutje, ankuesit më datë 25.01.2021, i janë drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimore se organi i punësimit me refuzimin e kompensimit të punës jashtë orarit ka shkelur të drejtën e kompensimit të punës jashtë orarit, e garantuar me Ligjin për Zyrtarët Publik, Ligjin e Punës si dhe aktet nënligjore. Ankuesit deklarojnë se kemi qenë të





angazhuar në Qendrën Operative të MPBAP për periudhën mars, prill dhe maj 2020, ku kemi punuar me orar 12 orë dhe se me vendim të ministrit kemi punuar si staf esencial i kësaj ministrie por që asnjëherë nuk na është bërë kompensimi prej 300 eurove dhe as kompensimi i punës jashtë orarit. Disa herë i jemi drejtuar me kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të MPB, për kompensim të punës jashtë orarit por që nuk kemi marr përgjigje lidhur kërkesën tonë. Propozojnë që Këshilli ta aprovoj ankesën e tyre si të bazuar dhe ta urdhëroj MPB për kompensimin e punës jashtë orarit në mënyrë retroaktive për periudhën mars, prill dhe maj 2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020 si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, vlerëson se çdo nëpunës civil ka të drejtën të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 ka përcaktuar se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht kërkesën e ankuesve të datës 05.06.2020 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MPB për kompensimin e punës jashtë orarit për periudhat si në ankesë si dhe ankesën e parashtruar me datë 13.01.2021 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave konstaton se ushtrimi i ankesës me datë 25.01.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes së organit të punësimit, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pas konstatimit se ankesa është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.25/2021**

**Flakron Gashi**

*por Belitaku*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-Dëmi**

*Ardita Haxhnikaj-Dëmi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHC-së